



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2022

Nr. 167

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE” NDAJ DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AUTORITETIT PORTUAL DURRËS Z. PIRRO VENGU, KRYETARIT TË BASHKISË DURRËS ZJ. EMIRIANA SAKO, DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT Z. KLEVIS HYSA DHE REKTORIT TË UNIVERISTETIT “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS ZJ. KSEANELA SOTIROFSKI, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022

Sot më datë 19 Maj 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

Kërkues: Organizata “Qendresa Qytetare”

Objekti: Kryerje e veprimtarisë publike në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor

Ndaj: Z. Pirro Vengu, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës
Zj. Emiriana Sako, Kryetar i Bashkisë Durrës
Z. Klevis Hysa, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Zj. Kseanela Sotirofski, Rektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” e “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N :

I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 26.02.2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar nga Organizata “Qendresa Qytetare”, denoncimi me nr. 3592, ID unik i gjeneruar nga sistemi, ora 4:22 PM, ku pretendohet se në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në datë 12.02.2022, në mjediset e Portit Durrës është zhvilluar një takim publik, me kandidaten për bashkinë Durrës dhe njëkohësisht kryetare e saj zj. Emiriana Sako, Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive z. Klevis Hysa, Rektorin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” zj. Kseanela Sotirofski dhe studentë pranë këtij universiteti dhe Drejtorin e Autoritetit Portual z. Pirro Vengu, ku u shpall Programi i Specializimit dhe Praktikave Profesionale.
2. Sipas denoncuesit “Në datë 12.02.2022, në mjediset e portit Durrës, është zhvilluar një takim publik, me kandidaten e Partisë Socialiste për kryetare të bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, e cila aktualisht është edhe kryetare e bashkisë, së bashku me Rektoren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, zj. Kseanela Sotirofski, Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, z. Klevis Hysa, Drejtorin e Autoritetit Portual dhe studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, ku u shpall Programi i Specializimit dhe Praktikave Profesionale. Ky takim vjen në një kohë që përkon me periudhën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e



Data: 19 Maj 2022

Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

pjeshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi nenin 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, pasi drejtues të organeve publike apo enteve te tjera, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia së tyre, marrin pjesë në një veprimtari me karakter politik, i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së. Gjatë këtij takimi, sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të kandidates, zj, Sako shkruan: “Bëmë të ditur se në fazën e parë do të jenë 10 të rinj, që do të përfitojnë eksperience pune për t’u integruar me profesionistë karriere në administratën portuale. Ne i’u bëmë të ditur studentëve se bashkia Durrës do të shpërndajë këtë vit 2000 kartat e para të studentit me të cilat ata do të përfitojnë një sërë lehtësirash në jetën e përditshme.”

3. Bashkëlidhur denoncimit të kërkuesit janë paraqitur fotografitë nga ky aktivitet dhe provat link :

- <https://www.durresport.al/index.php/portfolio/shpallja-e-programit-te-specializimit-dhe-praktikave-profesionale-ne-fushen-e-administrimit-portual-10-shkurt-2022/?fbclid=IëAR22Zlj7y2jy9xfHUIXz-SuCGaMNMXISYd0RzKQl7ËLuUXSËtqCëKjpLSk>
- <https://www.facebook.com/emiriana.sako/posts/336030588534426>
- <https://www.facebook.com/durresportauthority/posts/360562206076155>
- <https://www.facebook.com/uamdoofficial/posts/1361710334274154>

4. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

5. Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.



Data: 19 Maj 2022

Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

6. Referuar nenit 7, të ligjit 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
7. Referuar nenit 82 e vijues, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga Organizata “Qendresa Qytetare” përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.
8. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj të denoncuarëve, për të cilët atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II. Rrethanat e faktit

9. Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020, ka miratuar vendimin nr. 9 *“Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.
10. Në denoncimin e raportuar pretendohet se, nga ana e Autoritetit Portual Durrës, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Univeristetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe ndaj bashkisë Durrës, është kryer një aktivitet i cili, bie në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.
11. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1295 prot., datë 28.02.2022, i ka kërkuar Autoritetit Portual Durrës, bashkisë Durrës, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Rektoratit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu”, informacion sqarues në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet.
12. Me shkresën nr. 726/1 prot., datë 03.03.2022, protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 1295/2 prot., datë 07.03.2022, Autoriteti Portual Durrës ka dhënë pretendimet e tij duke sqaruar se, **“Aktiviteti është zhvilluar në datën 11.03.2020, në orën 11:0,0 dhe në këtë aktivitet**



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

kanë qenë pjesëmarrës bashkia Durrës e përfaqësuar nga kryetarja e bashkisë zj. Sako, partnerë nga Qendra e Ekselencës për Çështjet Detare (CEMA) dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Aktiviteti i kryer është i një karakteri teknik dhe ka lançuar programe për profesionistët e rinj. Aktiviteti i kryer nuk ka qenë mediatik dhe as i hapur për publikun e gjerë. Duke mos përmbushur kërkesat e nenit 92, të Kodit Zgjedhor, ky aktivitet nuk është raportuar”.

13. Nëpërmjet shkresës nr. 2070/1 prot., datë 02.03.2022, protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 1295/1 prot., datë 04.03.2022, bashkia Durrës ka sqaruar se, “Përfaqësuesi i Bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako, o ka qënë në cilësinë e të ftuarit në aktivitetin e zhvilluar nga Autoriteti Portual Durrës dhe për sa më sipër, detyrimi për raportim i takon organizatorit të aktivitetit”.
14. Nëpërmjet shkresës nr. 368/1 datë 04.03.2022, protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 1621 prot., datë 04.03.2022, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka sqaruar se në datën 08.02.2022, është përcjellë zyrtarisht ftesa për pjesëmarrje në aktivitetin për “Shpalljen e programit të Specializimit dhe Praktikave Profesionale në fushën e administrimit portual”. Autoriteti Portual Durrës, Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) kanë nënshkruar “Memorandumin e Mirëkuptimit” në datën 27.05.2021, për një kohëzgjatje deri në 31.12.2024. Pjesëmarrja në këtë aktivitet ka qenë në kuadër të partneritetit dhe marrëveshjes së institucionit me Qendrën e Ekselencës për Çështjet Detare (CEMA).
15. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1721 prot., datë 11.03.2022, përcjell për njohje gjetjet e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Autoritetit Portual Durrës, Kryetarit të Bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako, Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, z. Klevis Hysa me funksion Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 6.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, palët në proces, janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.
16. Brenda afatit të përcaktuar bashkia Durrës, nëpërmjet shkresës nr. 2070/3 prot., datë 18.03.2022, administruar me tonën nr. 1847 prot., datë 23.03.2022, paraqiti prapësime në lidhje me denoncimin e pretenduar.
17. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2126 prot., datë 11.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 13 Prill 2022, ora 13:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj Autoritetit Portual Durrës, Kryetarit të Bashkisë zj. Emiriana Sako, Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, z. Klevis Hysa me funksion Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

18. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, e autorizuar nëpërmjet shkresës datë 11.04.2022, e administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore, z. Aleks Marku, me detyrë Drejtor i Divizionit Juridik pranë Autoritetit Portual Durrës, autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 1410 prot., datë 13.04.2022, administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore, zj. Blerina Qyrana, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 1435 prot., datë 13.04.2022, administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore, zj. Anjeza Bejko përfaqësuese e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 620/1 prot., datë 13.04.2022, administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore dhe z. Arben Isaku, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ligjore në Bashkinë Durrës, i autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 2350/1 prot. datë 15.03.2022 administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi palëve, të parashtronjë pretendimet e tyre në lidhje me denoncimin.

Pretendimet e palëve:

19. Në shpjegimet e tij, përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare”, konfirmoi edhe njëherë denoncimin e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pretenduar se në këtë aktivitet është bërë shpallja e programit të specializimit dhe praktikave profesionale në fushën e administrimit portual. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe persona të ndryshëm duke pasur një pjesëmarrje të gjerë. Denoncuesi pretendon se kemi të bëjmë me një aktivitet me karakter publik, pasi synon shpalljen e një thirrjeje publike të gjerë për persona të interesuar. Referuar ftesës të vënë në dispozicion nga provat e administruara, citohet “*Ju ftojme në aktivitetin e thirrjes publike*”, një tjetër fakt ky që provon se kemi të bëjmë me një aktivitet me karakter publik, ku duhej të ishte raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Ftesa për këtë aktivitet i është drejtuar personalisht me e-mail zj. Emiriana Sako, për pjesëmarrjen e saj, në kuadër të projekteve të bashkisë. Duke qenë se ndodhej në kohën në periudhës zgjedhore dhe kandidatët ishin shpallur, prezenca e zj. Emiriana Sako, i jep asaj mundësinë për t’u prezantuar tek votuesit, për të dhënë premtime të karakterit politik dhe për të marrë mbështetjen prej tyre në zgjedhjet e mbajtura më datë 6 Mars 2022. Thirrja për këtë aktivitet publik synon të nxisë kryesisht pjesëmarrjen e studentëve, për t’u ofruar rritjen e aftësive profesionale dhe praktikë të studentëve të cilët me vonë do të nxisin punësimin e tyre. Zj. Kurti kërkoi nga përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës, administrimin si provë shtesë të planit vjetor, me data të përcaktuara, të këtij institucioni.



Data: 19 Maj 2022

Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

20. Në shpjegimet e tij, përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës, sqaron se lidhur me aktivitetin objekt denoncimi, është aktiviteti i karakterit teknik mes partnerëve të CEMA (Qendra e Trajnimit të Autoritetit Portual Durrës) dhe përfaqësuesve të institucioneve që mbulojnë veprimtarinë në fushën detare. Thirrja të cilët i referohet pala denoncuese është ftesë drejtuar partnerëve dhe jo një ftesë për pjesëmarrje të gjerë publike në këtë aktivitet. Autoriteti Portual Durrës sqaron se, në këtë takim mediat nuk kanë qenë të ftuar dhe nuk kanë qenë të pranishëm. Ky takim ka pasur të bëjë me një program për zhvillimin e aftësive profesionale dhe praktike për studentët. Referuar nga sa më sipër, Autoriteti Portual vlerëson se nuk kemi të bëjmë me aktivitet të karakterit publik dhe se nuk kategorizohen në kushtet për të raportuar në ndërfaqen e KQZ, pasi nuk janë në shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
21. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të pretendimeve të palëve kërkoi nga Autoriteti Portual Durrës, që brenda një afati të arsyeshëm të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve planin vjetor të tyre, kjo sipas kërkesës së zj. Kurti.
22. Në përfundim të afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi. Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, të Komisionit Rregullator “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 148, datë 26 Prill 2022, “Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Emiriana Sako, Autoritetit Portual Durrës, z. Klvis Hysa, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Punës dhe Aftësive dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë”, vendosi zgjatjen e afatit me 60 (gjashtëdhjetë) ditë të tjera.
23. Nëpërmjet shkresës nr. 1410/1 datë 26.04.2022, administruar me tonën nr. 2283 prot., datë 28.04.2022, Autoriteti Portual Durrës, ka depozituar pranë KQZ-së dokumentacionin e kërkuar nga përfaqësuesi i organizatës “Qëndresa Qytetare” në seancën dëgjimore të datës 13 Prill 2022.
24. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2270 prot., datë 27.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 27 Prill 2022, ora 12:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj Autoritetit Portual Durrës, kryetarit të bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, z. Klevis Hysa me funksion Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

25. Në seancën dëgjimore të datës 28.04.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, janë paraqitur përfaqësuesi i Qendresës Qytetare z. Rigels Xhemollari, përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës z. Aleks Marku, përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive zj. Blerina Qyrana dhe përfaqësuesi i rektoratit të Univeritetit “Aleksander Moisiu” zj. Anjeza Bejko. Në këtë seancë dëgjimore mungonte përfaqësuesi i bashkisë Durrës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi palëve, të parashtronjë pretendimet paraprake në lidhje me denoncimin. Përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës, sqaroi se ka përmbushur detyrimin për dërgimin e planit vjetor të këtij institucioni kundrejt denoncuesit dhe KQZ-së. Pala denoncuese konfirmoi se ishte njohur me materialet e dërguara nga Autoriteti Portual Durrës.

26. Pretendimet e palëve:

- **Përfaqësuesi i organizatës “Qendresa Qytetare”,** z. Xhemollari në parashtrimet e tij përfundimtare tha se, u përmbahet argumentave të tij të paraqitura me shkrim dhe denoncimit. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga Autoriteti Portual Durrës dhe nga Rektorati i Univeritetit “Aleksandër Moisiu”, aktiviteti është zhvilluar nga Qendra e Ekselencës për Çështjet Detare (CEMA), e cila është pjesë integrale e Autoritetit Portual Durrës dhe jo një entitet më vete. Përsa i përket aspektit të llojit të aktivitetit, referuar dhe ftesës nga Autoriteti Portual Durrës, është kryer një thirrje publike nga ana e institucionit dhe në këtë aktivitet ka pasur një pjesëmarrje të konsiderueshme, duke e bërë këtë aktivitet publik në karakterin e tij.

Referuar përmbajtjes së aktivitetit, zj. Emiriana Sako, kryetarja e Bashkisë Durrës, në rrjetet e saj sociale ka publikuar se do të përfitojnë eksperiencë pune 10 të rinj pranë këtij institucioni, do të shpërndahen 2000 karta student, si dhe do ketë lehtësira të tjera. Në vetvete, këto janë premtime elektorale. Pretendimi i mësipërm vërtetohet edhe nga plani vjetor i dërguar nga Autoriteti Portual Durrës, i cili parashikon se qëllimi i këtij aktiviteti është punësimi i të rinjve në fushën e detarisë.

Përfaqësuesi gjithashtu parashitroi se, ftesa për pjesëmarrje në këtë aktivitet i është dërguar zj. Sako në e-mail saj personal dhe jo në atë të bashkisë, gjë e cila implikon dhe vërteton se i është dërguar në kuadrin e kandidatit për kryetar. Për më tepër, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator përcakton se drejtuesit e institucioneve, që marrin pjesë në veprimtari me karakter publik, duhet të raportojnë në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjë e cila nuk është kryer.

- **Përfaqësuesi i Autoritetit Portual Durrës,** z. Aleks Marku u shpreh se, u qëndron shpjegimeve të dërguara pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu sqaroi se aktiviteti me titull “Thirrje Publike” nuk e bën aktivitetin publik në vetvete, pasi është një vendim i ngushtë ndërinstitucional dhe është kryer në përputhje me vendimet e Komisionit Rregullator. Këto vendime përcaktojnë se, që një aktivitet të quhet “aktivitet publik” duhet të këtë pjesëmarrjen e publikut ose medias në mënyrë që



Data: 19 Maj 2022

Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Univeritetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

institucionet të kenë detyrimin për raportim. Në rastin konkret, nuk ka qenë një aktivitet publik dhe Autoriteti Portual Durrës, nuk ka pasur detyrimin për raportim, ashtu si pretendohet nga denoncuesi. Si përfundim, kërkoi pushimin e hetimit administrative për moskonstatim të shkeljeve.

- **Përfaqësuesi i rektoratit të Universitetit “Aleksander Moisiu”** Durrës, zj. Bejko, gjatë seancës tha se u qëndronin pretendimeve të dërguara në mënyrë shkresore pranë institucionit. Gjithashtu, përfaqësuesi tha se takimi është kryer në kuadrin e marrëveshjes ndërinstitucionale, që ekziston ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, dhe se takimi i ka shërbyer qëllimit të kësaj marrëveshje. Pjesëmarrja në këtë aktivitet ka qenë në cilësinë e të ftuarit, ka qenë një aktivitet ndërinstitucional dhe jo publik. Përsa i përket pretendimeve të denoncuesit se zj. Sako, ka kryer premtime elektorale për kartat e studentëve në këtë takim, u sqarua se pajisja me karta është detyrim ligjor dhe nuk ka pse të bëhet premtim në lidhje me këtë çështje. Si përfundim, kërkon që të mos merret parasysh denoncimi në lidhje me rektoratin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”.
- **Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive**, zj. Qyrana gjatë seancës tha se, u qëndronin parashtrimeve të bëra në shkresën nr. 726/1 datë 03.03.2022, dhe theksoi se institucioni që ajo përfaqëson, nuk ka pasur detyrimin për raportim pasi ka qenë në cilësinë e të ftuarit, takimi nuk ka qenë publik dhe nuk ka pasur përmbajtje politike, si dhe ka pasur pjesëmarrës vetëm nga institucionet e ftuar në aktivitet. Zj. Emiriana Sako ka qenë e ftuar në cilësinë e kryetarit të bashkisë dhe jo në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie. Në përfundim, kërkohet moskonstatimin e shkeljeve.

III. Analiza ligjore

27. Qendra e Ekspertëve për Çështjet Detare është një platformë bashkëpunimi ndërmjet palëve të interesuara kombëtare dhe rajonale në çështjet detare. Kjo qendër është themeluar nga Autoriteti Portual Durrës dhe ka si partner Univeristetin “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Institutin për Bashkëpunim dhe Zhvillim, me mbështetjen e Sekretariatit të Përhershëm të Komunitetit të Transportit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
28. Takimi i kryer në datën 11.02.2022, ka pasur për qëllim lançimin e programit për profesionistët e rinj në fushën e detarisë dhe është zhvilluar ndërmjet përfaqësuesve të partnerëve të “Memorandum Mirëkuptimit” i lidhur më 27.05.2021, dhe i vlefshëm deri në 31.12.2024, dhe një numër të kufizuar të ftuarish, të cilëve iu prezantua platforma se si të rinjtë, **me njohuri**



Data: 19 Maj 2022

Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

specifike në fushën e detarisë, do mund t’u krijohej mundësia e praktikave profesionale pranë Autoritetit Portual Durrës.

29. Në përmbushje të nenit 5, pika 1 “të Memorandum Mirëkuptimit” bashkëpunimi ndërmjet palëve do të kryhet **përmes komunikimit të drejtpërdrejtë**, partnerët e Qendrës së Ekselencës për Çështjet Detare dhe personave të ftuar me **ftesë të posaçme** nga ana e Autoritetit Portual Durrës, janë mbledhur **për t’u njohur me aspektet teknike** të programeve të specializimit dhe praktikave të punës për të rinjtë. Në këtë takim nuk ka të pranishëm nga media vizive apo të shkruar dhe as të pranishëm nga publiku i gjerë, përveç atyre të ftuar dhe që kanë pasur interes të drejtpërdrejtë me qëllimin e këtij aktiviteti.
30. Referuar nenit 92, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, “Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, **janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik** që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë **të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias**, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.
31. Publikimi i këtij aktiviteti në faqen personale të rrjetit social “Facebook” të kryetarit të bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako dhe të Autoritetit Portual Durrës, nuk e kategorizon aktivitetin si publik. Referuar vendimit nr. 4, datë 22.01.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve **“Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë. Nga ana tjetër, Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1, e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’u konsiderojë veprimtarinë publike”**.
32. Të ndodhur në këto kushte, Autoriteti Portual Durrës, nuk ka pasur detyrimin për raportim të aktivitetit pasi aktiviteti i kryer nga ana e tyre ka pasur një “listë të mbyllur” të ftuarish dhe nuk ka pasur prezencë të mediave. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, konsideron të arsyeshme të vlerësojë se publikimi i kryer nga ana e Autoritetit Portual Durrës të njoftimit për shpalljen e programit të specializimit dhe praktikave profesionale në administrimin portual në faqen zyrtare të tij, nuk duhet parë si mbështetje apo promovim për interesa elektorale të kandidatës për kryetare të bashkisë zj. Emiriana Sako, por si pjesë e programit të transparencës së institucionit.
33. Konsiderohet e rëndësishme të përmendet fakti se zj. Emiriana Sako është regjistruar si kandidat për kryetarin e bashkisë Durrës, në datën **11 Shkurt 2022, ora 17:30**, nëpërmjet vendimit nr. 64, “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Emiriana Hiqmet Sako për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

të datës 6 mars 2022”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Aktiviteti i kryer pranë Autoritetit Portual Durrës, me praninë e Kryetarit të Bashkisë Durrës, është kryer në orën 11:00 AM deri në 11:40 AM, pra zj. Emiriana Sako, nuk e kishte marrë ende statusin e kandidatit për kryetar, gjë e cila do ta bënte edhe subjekt të hetimit nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për përdorim të fondeve publike për fushatë zgjedhore. Për atë kohë sa, ligjërisht zj. Emiriana Sako nuk ka pasur statusin e “kandidatit për kryetar” duhet gjykuar vetëm si kryetar i bashkisë Durrës dhe si përfaqësues i saj në aktivitetet ku ka qenë i ftuar.

34. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe seancave dëgjimore, nuk rezulton që objekti rast denoncimi ndaj Autoritetit Portual Durrës, Bashkisë Durrës, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Rektoratit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, është në shkelje të neneve 91 dhe 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” e “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S I :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Pirro Vengu Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës, zj. Emiriana Sako Kryetar i Bashkisë Durrës, z. Klevis Hysa Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit dhe zj. Kseanela Sotirofski Rektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.
2. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI



Data: 19 Maj 2022
Nr. 167

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”